

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-6403
Më 15.1.2014

Kryetari i Komunës, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës–Sektori Teknik për lejimin e shpalljes së tenderit për sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve komunale, mori këtë:

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës–Sektori Teknik i datës 13.1.2014 për lejimin e sigurimit fizik dhe mirëmbajtjen e objekteve të Komunës së Prizrenit, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës –Sektori Teknik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës–Sektori Teknik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-6401
Më 15.1.2014

Kryetari i Komunës, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës–Sektorit Teknik për lejimin e shpalljes së tenderit për larjen e jashtme dhe të brendshme të auto veturave, mori këtë:

KON KLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës–Sektorit Teknik i datës 13.1.2014, për lejimin e larjes së jashtme dhe të brendshme të auto veturave zyrtare të Komunës së Prizrenit për vitin 2014, për këtë qëllim lejohe shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës –Sektorit Teknik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës–Sektorit Teknik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-6404
Më 15.1.2014

Kryetari i Komunës, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës – Sektori Teknik, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim dhe vendosjen e aparateve klimatizuese, mori këtë:

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës-Sektorit Teknik i datës 13.1.2014, për lejimin e furnizimit dhe vendosjen e aparateve klimatizuese në hapësirat e objekteve zyrtare të Komunës së Prizrenit, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Aparatet klimatizuese duhet të jetë të madhësisë 480 kw dhe 900 kw.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës –Sektorit Teknik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës–Sektorit Teknik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-6397
Më 16.1.2014

Kryetari i Komunës, pasi shqyrtoi propozimin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, të datës 13.2.2012, për ndarjen dhe dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të një lokacioni (trualli) në pronësi të komunës, Skender Gashit nga fshati Zojz, mori këtë:

KON KLUZION

U shqyrtua propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, i datës 16.1.2014, për ndarjen dhe dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të një lokacioni (trualli) në sipërfaqe prej 2 ari nga sipërfaqja e përgjithshme prej 3174 m², në ngastrën kadastrale P-71813028-00180-0, ZK Zojz, pronë e KK Prizren, me qëllim të vendosjes së kontejnerit nga ana e CIMIK-ut austriak si donacion, për z. Skender Gashin nga fshati Zojz.

Ky propozim i procedohet: Komisionit për Pronë, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe vendimmarrje.

Obligohet Zyra për Komunitete dhe Kthim që, pas marrjes së këtij konkluzioni, të procedojë me lëndën në Komitetin për Politikë dhe Financa, Komisionin e Pronës dhe Kuvendin e Komunës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Zyra për Komunitete dhe Kthim, dhe Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrës.

Me këtë konkluzion të njoftohen Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrës, CIMIK-u austriak, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-8691
Më 22.1.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit dhe Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204, pas propozimit të Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, kryetari i Komunës, me 22 janar 2014, mori këtë:

AKTVENDIM

Për formimin, përbërjen, emërimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit për Shqyrtimin e Ankesave nga Tatimi në Pronë

I. Formohet dhe emërohet Bordi për shqyrtimin e ankesave nga tatimi në pronë. Anëtarë të këtij komisioni, emërohen:

1. Islam Osmankaj - kryetar;
2. Emire Mashkulli - anëtare;
3. Bashkim Lubovci – anëtar.

II. Komisioni, nga pika I e këtij Aktvendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me ligjin në fuqi.

III. Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, si dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim, të njoftohen Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, të emëruarit, Departamenti i Tatimit në Pronë, si dhe Arkivi.

Ky Aktvendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-43730
Më 10.1.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, rreth mbështetjes financiare për organizimin e ceremonisë lidhur me shpalljen e më të dalluarve nga lëmi i sportit, rinisë dhe kulturës për vitin 2013, kryetari i Komunës më 10 janar 2014, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, rreth mbështetjes financiare për organizimin e ceremonisë lidhur me shpalljen e sportistëve më të mirë dhe shpalljen e më të dalluarve nga lëmi i rinisë dhe kulturës për vitin 2013, kështu që, me qëllim të organizimit të kësaj ceremonie, lejohen mjetet e nevojshme.

Shpenzimet e ceremonisë përkatëse do të mbulohen pas prezantimit të faturave.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicionet e subvencioneve dhe mallrave dhe shërbime.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-8690
Më 20.1.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë për lejimin e kontraktimit të punës për punë specifike për kohë të caktuar për Dr. spec. Rami Krasniqi, neuropsikiatër, kryetari i Komunës më 20 janar 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Lejohet kontraktimi i punës për punë dhe detyra specifike për kohë të caktuar për 120 ditë për Dr. spec. Rami Krasniqi, neuropsikiatër në kuadër të Kujdesit Primar Shëndetësor të Komunës së Prizrenit.

Neni 2

Dr. spec. Rami Krasniqi, neuropsikiatër do të jetë anëtar i komisionit në kuadër të Kujdesit Primar Shëndetësor të Komunës së Prizrenit me qëllim të dhënies së certifikatave shëndetësore për nevojat e marrjes së lejes për drejtim të automjeteve.

Neni 3

Në emër të punëve të kryera përkatësisht në bazë të numrit (seancave) të komisioneve të mbajtura, personi i lartcekur, do të kompensohen nga të hyrat vetanake (participimi).

Neni 4

Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë që ti zhvilloj procedurat e nevojshme ligjore për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 6

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-9995
Më 27.1.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural rreth lejjimit të mjeteve për vaksinimin e qenve kundër tërbimit, kryetari i Komunës më 27 janar 2014 miratoi këtë:

V E N D I M PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i datës 22.1.2014 për lejjimin e mjeteve për vaksinimin e qenve kundër tërbimit (Rabies-it), kështu që për këtë qëllim nga buxheti i Komunës - pozicioni përkatës, lejohen mjetet në lartësi prej 7000 €, përkatësisht nga 2 € për çdo qen të vaksinuar.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicionet e Drejtorisë Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-9978
Më 27.1.2014

Kryetari i Komunës, pas propozimit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e shpalljes së tenderit për ngritjen e 25 serrave, me participim me fermerët, mori këtë:

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i datës 22.1.2014 për lejimin e ngritjes së 25 serrave me participim me fermerët, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për ngritjen e:

- a. 15 serrave me 240 m² dhe
- b. 10 (dhjetë) serrave me nga 144 m².

Përfituesit e këtij projekti (fermerët) do të participojnë me 25 % të vlerës së serrës ndërsa Komuna me 75 % të vlerës përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-9990
Më 27.1.2014

Kryetari i Komunës, pas propozimit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e shpalljes së tenderit për eliminimin të qenve endacakë, mori këtë:

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i datës 22.1.2014 për lejimin e eliminimit të qenve endacakë në territorin e Komunës së Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-9978
Më 27.1.2014

Kryetari i Komunës, pas propozimit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejin e shpalljes së tenderit për subvencionimin e fermerëve të Komunës së Prizrenit me farë të misrit, mori këtë:

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i datës 22.1.2014 për lejin e mjeteve për subvencionimin e 800 ha të fermerëve të Komunës së Prizrenit me farë të misrit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja